



KOLEGJI EVROPIAN “DUKAGJINI” (KED)
EUROPEAN COLLEGE DUKAGJINI (ECD)

DIPLOMIMI NË KOLEGJIN EVROPIAN “DUKAGJINI”

RREGULLORE MBI DIPLOMIMIN NË NIVELIN BAÇELLËR

Pejë, 2011

Diplomimi në nivelin Baçellër në Kolegjin Evropian “Dukagjini”

Studenti në shkallën e parë të studimeve – tre vjeçare (BA degree) diplomon në qoftë se pas dhënies së të gjitha provimeve të parapara me këtë shkallë të studimeve e mbronë punimin e diplomës para komisionit tre – anëtarësh.

Studenti përcaktohet për një mësimdhënës i cili do të jetë udhëheqës – mentor gjatë punimit të tij të diplomës. Mentor i studentit mund të jetë secili mësimdhënës që i ka mbajtur mësim studentit, me thirrjen akademike së paku Ligjërues.

Punimi i diplomës merret në semestrin e fundit (të gjashtë ose të tetë) të studimeve dhe punohet gjatë tërë semestrit, paralelisht me mësimin praktik të obliguar.

Në vazhdim është e paraqitur Rregullorja mbi hartimin e punimit të diplomës të nivelit Baçellër:

RREGULLORE mbi hartimin e punimit të diplomës

Neni 1.

Me këtë rregullore rregullohet mënyra e paraqitjes, hartimit dhe e vlerësimit të punimit të diplomës në Kolegjin Evropian “Dukagjini” në Pejë.

Përcaktimi i Punimit të diplomës – Baçellër i shkencës

Neni 2.

Për marrjen e diplomës mbi studimet themelore të përfunduara në Kolegjin Evropian “Dukagjini” në Pejë, është e nevojshme që studentin, përveç provimeve të dhënë dhe kryerjes së obligimeve të tjera, të hartojë edhe punimin e zgjedhur të diplomës.

Punimi i diplomës parimisht merret nga lëndët e obliguara të përmbytjeve të veçanta programore, por mund të merret edhe nga lëndet e zgjedhura. Komiteti për politikë akademike apo Këshilli i Fakultetit/Departamentit vendos për punimet e diplomave dhe nga cilat lëndë mund të merren.

Neni 3.

Studenti që diplomon në Kolegjin Evropian “Dukagjini” Pejë në shkallën Baçellër të studimeve duhet ta zgjedhë temën për punimin e diplomës nga disiplinat shkencore – mësimore të cilat i ka studiuar gjatë studimeve trivjeçare.

Neni 4.

Punimi i diplomës është përpunim i pavarur i temës së përcaktuar.

Me hartimin e punimit të diplomës studenti duhet të tregon aftësi dhe pavarësi të zgjedhjes së problemeve nga fusha shkencore – mësimore të cilat kanë qenë përmbajtje e studimeve të tij.

Dimensioni evropian në punimin e diplomës

Neni 5.

Në bazë të udhëzimeve të Deklaratës së Bolonjës, tema e diplomës duhet të ketë dimensionin evropian, si parakusht për përgatitje të profesionistëve për tregun evropian të punës. Temat profesionale dhe ato që kanë të bëjnë me regjionin specifik të vendit të caktuar, duhet të janë të orientuara në kontekst me zhvillimet në Evropë dhe të përdorshme për tregun evropian të punës.

Neni 6.

Tema e hartimit të diplomës në përmbajtjen e vet, sipas rregullit duhet të përfshinë, përveç pjesës teorike, mundësitë e zgjedhjes së problemeve konkrete shoqërore – ekonomike.

Përmbajtjen e punimit të diplomës me propozim të studentit, e konfirmon mentori, i cili është mbikëqyrës dhe garantues i përmbajtjes së punimit. Gjatë hartimit të punimit të diplomës, studenti është i obliguar që vazhdimisht të bashkëpunojë me mentorin.

Shpallja e regjistrimit të temave të mundshme të diplomës

Neni 7.

Regjistrin e temave të punimeve të diplomave, sipas propozimit të mësimdhënësit e lejon Këshilli i fakultetit/departamentit ose Komiteti për politikë Akademike të Universitetit.

Temat e propozuara për punimin e diplomave prezantohen publikisht në tabelën e shpalljeve të Universitetit në fillim të çdo viti akademik në mënyrë që në kuadër të tyre studenti ta bën zgjedhjen e temës së caktuar. Studentet më korospondencë që kanë vend pune në ndërmarrje mund të propozojnë temen e cila nuk është shpallë në katalogun e temave për punimet e diplomimit e që është në harmoni me nevojat e ndërmarrjeve në të cilat punojnë, por gjithnjë në marrëveshje me mësimdhënësin e lëndës.

Studentet mund të propozojnë edhe temen e cila nuk është shpallë në katalogun e temave për punimet e diplomimit e që është në harmoni me nevojat momentale kërkimore dhe profesionale, por gjithnjë në marrëveshje me mësimdhënësin e lëndës.

Paraqitja për temë të punimit të diplomës

Neni 8.

Studenti është i obliguar që temen e punimit të diplomës ta paraqet në vitin e tretë të studimeve.

Studenti i rregullt është i obliguar që temen ta paraqet deri në fillimin e semestrit të gjashtë.

Neni 9.

Studenti zgjedhë temen në atë mënyrë që me vërejtjet dhe udhëzimet e mësimdhënësit – mentorit bën konceptin e punimit të diplomës. Në procedurën e përcaktimit të temës së punimit të diplomës, studenti është i obliguar që bashkë me temen

dhe përmbajtjen e punimit të diplomës, ta citojë edhe literaturën dhe materialet tjera me të cilat do të shërbehet me rastin e hartimit të punimit të diplomës.

Lejimi i temës për punim diplome

Neni 10.

Koncepti i prëpunimit të punimit të diplomës me propozim të përmbajtjes i dorëzohet mentorit. Mentori propozon dy anëtarë të komisionit për mbrojtjen e punimit të diplomës.

Neni 11.

Dekani, Koordinatori për cilësi apo përgjegjësi për mësim i departamentit e bejnë shikimin dhe e lejojnë temën si dhe konceptin e punimit të diplomës dhe poashtu, vërtetojnë zgjedhjen e Komisionit për mbrojtjen e punimit të diplomës.

Kualiteti i punimit të diplomës

Neni 12.

Me rastin e hartimit të punimit të diplomës, studenti duhet të ketë kujdes për përmbajtjen e domosdoshme dhe kualitetin formal të punimit. Në kualitete formale hyjnë: stili, gjuha, drejtshkrimi, faqet e punimit, klasifikimi dhe radhitja e përmbajtjes, citimi i burimeve me fusnota, regjistrimi i rregullt i literaturës së përdorur sipas radhës së alfabetit të autorëve dhe shënimet tjera të literaturës, regjistrimi dhe pasqyra e dokumentacionit.

Në kualitetin e përmbajtjeve të punimit hyjnë: respektimi konsekuent i temës, aplikimi korrekt i metodës së analizës dhe sintezës si dhe metodave të tjera gjegjëse shkencore, argumentimi i qendrimeve, shprehja e rregullt e qendrimeve, konkludimeve, propozimeve etj.

Në qoftë se studenti gjatë studimeve ka bërë një ose më shumë punime të cilat për nga përmbajtja dhe vëllimi i përgjigjen punimit të diplomës, ai punim (ose punime) mund të pranohet si punim i diplomës, në qoftë se një Komision adekuat profesional e propozon këtë.

Të dhënat teknike për përmbajtjen e punimit

Neni 13.

Punimi i diplomës shkruhet me kompjuter në letër të formatit A4 (21 X 29.7 cm) dhe përbëhet nga:

- kopertinat (shtojca nr. 3)
- fleta e pastër
- fletët e tjera të brendshme (shtojca 4)
- Përmbajtja
- Pjesa hyrëse
- Përpunimi i temeve sipas kaptinave
- Përfundimi (përfundimet) në gjuhën shqipe dhe angleze
- Regjistrimi i literaturës dhe burimeve të tjera që janë shfrytëzuar.
- regjistri i shtojcave (nëse ekzistojnë në punim).

Literatura e cekur përdorët në këtë mënyrë:

- a) Librat (Mbiemri, Titulli shkencor, emri i autorit, titulli i librit, botuesi, vendi i botimit, viti i botimit).
- b) Revistat (titulli, artikulli, autori, botuesi, vendi, viti).
- c) Të tjera (ligje, rregullore etj).
- d) Burimet nga Interneti, shënohet URL adresa e plotë dhe data.

Punimi i diplomës në studime Baçellër duhet të përfshihet në minimum 40 faqe me të dhënat teknike vijuese:

- Paragrafet shkruhen në rreshta të gjerësisë 1,5 të Paragrafit,
- Teksti i zakonshëm shkruhet me shkronja e tipit Times New Roman, 12 pts i renditur majtas dhe djathtas (justified).
- Titujt shënohen me shkronja Bold të tipit Times New Roman ose Arial të renditur në mes, me madhesi 12 pts, 13 pts ose 14 pts.
- Teksti i fusnotave dhe i tabelave shënohet me shkronja të pjerrëta (*italike*) të madhësisë 10 pts.
- Në fund të faqes (në mes apo djathtas) shënohet numri i faqes.
- Faqet shtypen vetëm në njërën anë të fletës.

Neni 14

Në pjesën tekstuale të temes studenti është i obliguar të udhëzojë në literaturën e shfrytëzuar dhe në burime tjera të shënimeve me të cilat është shërbyer.

Çdo punim i huaj, duhet të theksohet apo shënohet në fusnota, pavarësisht se a është cituar drjetpërdrejtë apo në mënyrë të tërthort, ose që është interpretuar.

Pjesët e theksuara (cituara) dhe interpretuara duhet të shënohen me numer nën numrin e njejtë, në fund të faqës, në fusnota, në të cilin vend duhet thenë:

- o nëse bëhet fjalë për libër: mbiemri dhe emri (ose inicialet) e autorit, titulli i vepres, emri i botuesit, vendi i botimit, viti i botimit dhe numri i faqës së cituar;
- o nëse bëhet fjalë për revistën: mbiemri dhe emri i autorit, titulli i artikullit, emërtimi i revistës, viti i botimit, numri i revistes dhe numri i faqës nga e cila është nxjerrë citati.

Literatura e cila është shfrytëzuar me rastin e hartimit të punimit theksohet në fund të punimit. Regjistri i literaturës sajohet sipas radhes alfabetike të mbiemrave të autorëve.

Të gjitha tabelat dhe paraqitjet grafike në tekst duhet të jenë të shënuara me numra dhe të kenë emrin dhe burimin e vetë, p.sh.

Tabela 7. Treguesit e zhvillimit të vendeve në tranzicion

VITI
1990				
1991				
1992				
Gjithsej				

Burimi: Vjetari statistikor për vitin 1990, Enti statistikor për statistikë i Republikës së Kosovës.

Foto. (grafikoni) 7 – Diagrami i bujtinave së musafirëve sipas muajve në hotel “X” në vitin 1992.....
Burimi:.....

Çdo tabelë, fotografi, grafikoni etj, duhet të jetë e përshkruar në atë mënyrë që të mund të kuptohet dhe automatikisht të përdoret pa pjesën e tekstit.

Neni 15.

Punimi i diplomës detyrimisht lidhet në kopertina të forta (trasha) dhe parimisht lidhet në kopertina me ngjyrë të Kaltërt të mbylltë me shkronja të verdha (ngjyrat e flamurit të Evropës dhe Kosovës).

Në kopertina shënohet:

KOLEGJI EVROPIAN “DUKAGJINI”

Fakulteti/Departamenti _____

Pejë

Emri dhe mbiemri i studentit

Titulli i punimit

Pejë, viti _____

Faqja e dytë

Në faqën e dytë (të brendshme) të titullit shënohen këto të dhëna:

KOLEGJI EVROPIAN “DUKAGJINI”

Fakulteti/Departamenti _____

Pejë

Emri dhe mbiemrit i studentit

Satusi (i rregullt ose me korospodencë)

Numri i amzës _____

Drejtimi dhe shkalla e studimit

Titulli i punimit

Punim diplome

Lënda nga e cila është berë punimi _____

Mentori i punimit _____

Muaji dhe viti

Neni 16.

Mentori dhe anëtarët e komisionit, në afat deri në një muaj prej marrjës së punimit, duke mos e llogaritur këtu kohën e pushimeve verore dhe të festave, janë të obliguar të vlerësojnë punimin e diplomës.

Në qoftë se dy anëtarë të komisionit e vlerësojnë negativisht punimin e diplomës, përkundër vlerësimit pozitiv të mentorit, mentori mund të kërkon nga Dekani të emërojë komisionin tjetër profesional prej tre antëtarësh i cili është i obliguar të shikon punimin e diplomës dhe dokumentacionin mbi vlerësimin e punimit të diplomës në kohë prej 14 ditësh, në formë të shkruar, ta njofton organit kompetent me propozim për vlerësimin përfundimtar.

Nëse mentori ose antarët e tjerë të komisionit vlerësojnë se punimi nuk është i përshtatshëm për mbrojtje, por punimi apo pjesa e tij duhet që të plotësohet ose të ndryshojë, Kryetari i komisionit ia kthen punimin studentit me udhëzim se çfarë duhet plotësuar (ndryshuar) në punim.

Neni 17

Në qoftë se punimi është vlerësuar pozitivisht, kandidati mund të hyjë vazhdojë mbrojtjen e tij.

Punimi i diplomës zyrtarizohet me protokolimin e tij në Administratë, pasi që janë krijuar së paku 4 kopje identike të punimit (1 për Bibliotekën e Universitetit dhe 3 për anëtarët e Komisionit) dhe 1 kopje digjitale e ofruar në CD ose në një mjet tjetër për ruajtje të informacionit, e cila poashtu deponohet në Bibliotekën elektronike të Universitetit.

Neni 18

Studentët janë të obliguar ta mbrojnë punimin e diplomes para komisionit treantarësh (mentorit dhe dy anëtarëve).

Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe mbahet në kohën që e cakton mentori në marrveshje me antarët e Komisionit dhe Administratën. Mentori për kohën e mbajtjes së mbrojtjes e lajmëron Administratën e studentëve e këta e lajmërojnë studentin.

Në mbrojtjen e punimit të diplomës verifikohet dija teorike dhe praktike si dhe aftësia e studentit që të merr mbrojtje dhe argumentojë përfundimet vetanake në lidhje me materien të cilën e ka përpunuar në punim.

Procedura e mbrojtjes së punimit të diplomës është si vijon:

- Kryetari i Komisionit e hap procedurën e mbrojtjes; Kandidati e prezanton problematikën themelore të punimit, metodat me të cilat është shërbyer dhe rezultatet të cilat i ka arritur në punim. Prezantimi zgjatë rrethë 10-15 minuta.
- Anëtarët e Komisionit i bëjnë pyetje kandidatit. Çdo antar mund t'i parashtrojë më së shumti 3 pyetje.
- Pas parashtrimit të pyetjeve, kandidati ka të drejtë të mendojë deri në 5 minuta, pas së cilës kohë duhet të përgjegjet në pyetje.
- Pasi që të përgjigjet në të gjitha pyetjet e parashtruara, Komisioni e shqyrton kualitetin e punimit të diplomës, paraqitjen gojore të kandidatit mbi punimin dhe përgjigjet e tij në pyetjet e parashtruara si dhe në bazë të kësaj përcakton notën përfundimtare të punimit të diplomës.

Notat e punimit të diplomës

Notat e punimit të diplomës janë: shkëlqyeshëm (10 ose 9), shumë mirë (8), mirë (7), mjaftueshëm (6) dhe pamjaftueshëm (5).

Neni 19

Në rast të mungësës në mbrojtje të punimit të një anëtari të Komisionit, Dekani me propozim të Mentorit mund të emërojë zëvendësin.

Nëni 20.

Nëse mentori dhe anëtarët e Komisionit vijnë deri te përfundimi se kandidati e ka mbrojtur me sukses punimin ose nëse kanë ardhur deri te konstatimi se në këtë nuk ka pasë sukses, ia komunikojnë kandidatit vlerësimin (notën) drejtpërdrejtë pas mbrojtjes. Kandidatit ia komunikon notën publikisht Kryetari i Komisionit.

Neni 21.

Me rastin e mbrojtjes së punimit të diplomës përpilohet procesverbali mbi provimin e diplomës, i cili përmban këto shënime:

- Numrin rendor (numrin e diplomës)
- Emrin dhe mbiemrin e studentit
- Numrin amzë
- Datën e regjistrimit të parë
- Statusin e studentit
- Tema e punimit të diplomës
- Vëllimi i punimit të diplomës (numri i faqeve, kapitujve, tabelave, figurave etj.)
- Mentori i punimit të diplomës
- Nota në punimin e diplomës
- Vërejtjet eventuale mbi punimin dhe mbrojtjen
- Emrat dhe mbiemrat si dhe nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit për mbrojtjen e punimit

Procesverbalin e plotëson Referenti ose Këshilltari i studentëve për ECTS dhe Kryetari i Komisionit për mbrojtje të punimit të diplomës.

Procesverbali mbi mbrojtjen e punimit të diplomës së bashku me Vërtetimin mbi dorëzimin e 1 kopje të punimit të lidhur dhe digjitale, të cilin e lëshon Biblioteka, i dorëzohet Administratës ku deponohet dhe ruhet.

Neni 22.

Kur kandidatit i komunikohet nota e dobët e punimit të diplomës, obligimisht ceken shkaqet për notë të tillë, të cilat hyjnë në procesverbal mbi vlerësimin e punimit të diplomës.

Kandidati, punimi i diplomës të të cilit është vlerësuar me notë të dobët, duhet të zgjedhë dhe të paraqesë temë tjetër të re për punim diplome.

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 23

Për interpretimin e dispozitave të caktuara të kësaj Rregulloreje është kompetent Komiteti për politikë akademike i Kolegjit Evropian “Dukagjini”.

Neni 24.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e tetë prej ditës së vënies në tabelën e shpalljeve të Kolegjit Evropian “Dukagjini”.